



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 38, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË TURISTIKE
HOTELERI DHE OBJEKT BANIMI ME 1, 2, 3, 4, 5 DHE 6, KATE MBI TOKË,
ME 1 KAT PARKIMI NËN TOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN SH8,
ORIKUM, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligj Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë zhvilluese “Mëhillaj” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë turistike hoteleri dhe objekt banimi me 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 kate mbi tokë, me 1 kat parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën Sh8, Orikum, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Mëhillaj” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregulores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyi në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT


MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 05/06 2025